



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 24 dhjetor 2014, në orën 10:00,
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Bislimi, Ali Sadriu, Duda Balje, Synavere Rysha, Bali Muharremaj, Naim Fetahu dhe Hajdar Beqa.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Adem Grabovci.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e komisionit dhe Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi në komision.

Mbledhjen e kryesoi: Besnik Bislimi, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Konstituimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetari pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Besnik Bislimi, kryetar, tha se fillimisht ju dëshiroj të gjithë deputetëve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, punë të mbarë. Po ashtu ai theksoi se KMFP-ja, në fushëveprimin e vet ka të bëjë me shqyrtimin e raporteve të auditimit të jashtëm për Institucione. Me angazhim të përbashkët tonin dhe veçanërisht të zëvendëskryetarit të parë z. Ali Sadriu, i cili ishte kryetar i komisionit në legjislaturën e katërt, do të arrijmë rezultate. Së bashku me sekretarinë e komisionit, do të përgatisim planin e punës së Komisionit për vitin 2015. Ky plan do të jetë gati qysh në muajin janar të vitit 2015.

Bislimi përshëndeti edhe përfaqësuesit e OSBE-së, të cilët morën morën pjesë në këtë takim, kurse më pas i njoftoi të pranishmit se më 22 më janar të vitit 2015, do të jetë e pranishme në Kosovë, kryetarja e Komisionit për Buxhet të Parlamentit të Gjermanisë. Pra, me këtë rast, tha Bislimi, do të jemi të gjithë së bashku në një konferencë për fushën e financave publike, që do të organizohet nga GIZ-i dhe më pas e hapi diskutimin.

Ali Sadriu përshëndeti deputetët, duke ju dëshiruar punë të mbarë. Po ashtu ai theksoi se institucionet të cilat kanë auditor të brendshëm kanë me pak telashe me auditimin e jashtëm. Ne jemi një komision që do të duhet të luajë rolin e një institucioni, i cili është mbikëqyrës i shpenzimit të parasë publike.

Bali Muharremaj po ashtu theksoi se është vështirë të merren vendime në këtë komision për shkak të përbërjes së komisionit, mirëpo, shpresoj se me një bashkëpunim të përbashkët me të gjithë anëtarët e komisionit, do të arrijmë qëllime të përbashkëta. Për një punë të përbashkët besoj do ta kemi përkrahjen e GIZ-it, OSBE-së si dhe të partnerëve të tjerë.

Duda Balje tha se nga legjislatura e kaluar që isha anëtare në komisionin e buxhetit dhe se përvojat e marra atje, do të mundohem ti jetësojë edhe në KMFP. GIZ-i ka ndihmuar shumë komisionin për buxhet, sikurse edhe përvojat e shteteve tjera, gjatë vizitave që janë bërë jashtë vendit.

Naim Fetahu tha se shpreson në bashkëpunimin e të gjithëve për arritjen e objektivave të përbashkëta dhe shtoi se ai ka përvojë në fushën e financave publike.

Hajdar Beqa theksoi se shikuar nga fushëveprimtaria e komisionit, shihet se është një komision me rendësi të veçantë dhe bazuar në përbërjen e këtij komisioni, nuk dyshoj se nuk do të kemi rezultate të kënaqshme. Do të mundohemi që këtu të kemi qasje profesionale, duke lënë anash partitë politike që përfaqësojmë. Do të mundohemi t'i respektojmë ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat rregullojnë këtë fushë.

Synavere Rysha theksoi se në legjislaturën e tretë është filluar për herë të parë me funksionalizimin e KMFP-së dhe se në atë kohë kam qenë anëtare e këtij komisioni. Po ashtu, tha kjo, është fat i madh që zëvendëskryetar të komisionit e kemi Ali Sadriun, i cili ka një përvojë të madhe në këtë fushë. Shpresoj se të gjithë së bashku do t'ia dalim që ti shqyrtojmë raportet e auditimit.

Në fund, kryetari i Komisionit, Besnik Bislimi, falënderoi deputetët për pjesëmarrje, ndërsa për takimin e radhës tha se ata do të njoftohen përmes sekretarisë së komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Kryetari i Komisionit

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Besnik Bislimi